



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FINIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 821 Prot.

FinIQ, më 01.04.2022

Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë

Lënda: Reflektimi i prioriteteve të komunitetit në tavanet përgatitore të PBA 2023 – 2024

I nderuar Z. Kryetar i Bashkisë,

Bazuar në të dhënat e Raportit të Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit të vitit 2021, Këshilli i Bashkisë hartoi një sondazh, përmes të cilit ka mbledhur rekomandimet e komunitetit mbi funksionet prioritare të bashkisë gjatë vitit 2023. Sondazhi ka qenë online për rreth një muaj (Shkurt – Mars 2022) dhe është shpërndarë përmes kanaleve të komunikimit të Këshillit të Bashkisë.

Sondazhit i janë përgjigjur 56 persona, nga të cilët rreth 42.9% janë femra dhe 57.1% janë meshkuj. Gjithashtu, pjesëmarrësit në sondazh janë nga të gjitha njësitë administrative të bashkisë.

Këshilli i Bashkisë, pasi analizoi rezultatet e sondazhit, vëren se funksionet e përfshira në programet e mëposhtme janë konsideruar prioritare nga mbi 50% e komunitetit:

- Programi 06260: Shërbimet publike vendore, përfshirë ndriçimin
- Programi 04130: Mbështetje për zhvillim ekonomik, turizmi, tregjet
- Programi 03280: Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile
- Programi 04240: Ujitja dhe kullimi
- Programi 06370: Furnizimi me ujë dhe kanalizime

- Programi 09230: Arsimi i mesëm dhe profesional
- Programi 10430: Kujdesi Social, Papunësia, Sigurimi shoqëror
- Programi 09120: Arsimi bazë dhe parashkollor

Për sa më sipër, rekomandojmë që gjatë procesit të përgatitjes së tavaneve përgatitore për PBA 23 – 25, bashkia të marrë parasysh dhe të reflektojë rekomandimet e komunitetit, duke planifikuar më shumë fonde për programet prioritare të sipërpërmendura.

Sekretari i keshillit bashkiak

Grigor ZAFIRI

